

Data 01/09/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Klori

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Klor
Hipoklorit natriumi

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 348 000 *(Tre million e treqinde e dyzete e tete mije) lekë pa tvsh*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujesjelles Kanalizime Kamez Sh.aka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së (Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së kontratës përkatësisht 1,339,200leke pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Wshtw kwrkuar vlera maksimale prej 40% e fondit limit pasi wshtw vlerw lehtwsisht e pwrballueshme nga OE.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022-2023, të konfirmuara nga Organet tatimore shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar (vetëm në rastin kur janë objekt i nenshkrimit të auditimit), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht,

Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. “

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikaten e prodhuesit që verteton konformitetin e produktit me standardin SSH EN 901: 2013 ‘Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor –Sodium hypochlorite’, shoqëruar me:

- Lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojin e kimikatit, në rast se operatori ekonomik është importues.
- Leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për kimikatin e kërkuar nga AK në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas (vetdeklarim në shtojcën nr.8).
- Kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për kimikatin e përcaktuara në DST ose Kontratë furnizimi ose autorizim me prodhuesin në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi dhe duke vlerësuar rëndësinë dhe ndjeshmërinë e objektit të kontratës pasi kemi të bëjmë me substancë e Klorit e cila do të përdoret për trajtimin e ujit të pijshëm, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës plotësojnë kërkesat e legjislacionit specifik për realizimin e kontratës. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e certifikates nga prodhuesi, lejes mjedisore, licensat dhe makinerinë e kërkuar kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

- standardin SSH EN 901: 2013 ‘Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor –**Sodium hypochlorite**’, percaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit.
- Ligj nr. 10 448, datë 14.7.2011 për lejet e mjedisit
- Ligj nr. 105/2014 për barnat dhe shërbimin farmaceutik

Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik ose nga laboratore të certifikuar, për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet (certificate analize brenda 3 muajve të fundit).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.pika 6/ c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, Autoriteti Kontraktore duke pasur parasysh natyrën e mallit për të cilin prokuron kërkon nga institucione shtetërore apo private të licencuara Analiza të cilat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara për produktin që prokurohet.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 mjet të autorizuar për transport mallrash të rrezikshme sipas standartit të BE

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Certifikate Pronesie, Leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme)

Dhe për mjetet e mara me qera, kontratën perkatese të Qerave/Huapërdorje të shoqëruar me Certifikate Pronesie leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme), për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Furnizimi me kimikate do të kryhet me automjet të certifikuar për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Automjeti për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme ose të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatit.

(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në specifikimeve teknike

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Informacioni në lidhje me specifikat kryesore për Hipokloritin e Natriumit

Hipokloriti i Natriumit duhet të plotesojë kushtet e mëposhtme

PH < 8.0

Koha e nevojshme e kontaktit > 30 minuta

Turbullira <0.5 NTU

Specifikimet Teknike

Hipokloriti I natriumit (NaOCl), “ Cilësia e Ujit të Pijshëm “ nga VKM nr 379 datë 25.05.2016

| Nr. | Parametrat | Njësia e matjes | Specifikat Kimike |
|-----|-------------------|-----------------|------------------------------------|
| 1 | Gjëndja | - | Lëng i kthjellët |
| 2 | Ngjyra | - | E Verdhë e çelët |
| 3 | Densiteti në 20°C | gr/ml | 1.13 - 1.28 |
| 4 | Titulli i Cl2 | % | 13.5 - 14.5 |
| 5 | Substanca Toksike | mg/kg | Limitet në mg/kg të klorit të lirë |
| 6 | Arsenik (As) | mg/kg | max 1 |
| 7 | Kadmium (Cd) | mg/kg | max 2.5 |
| 8 | Krom (Cr) | mg/kg | max 2.5 |
| 9 | Merkur (Hg) | mg/kg | max 2.5 |
| 10 | Nikel (Ni) | mg/kg | max 2.5 |
| 11 | Plumb (Pb) | mg/kg | max 15 |

| | | | |
|----|--------------|-------|--------|
| 12 | Antimon (Sb) | mg/kg | max 20 |
| 13 | Selen (Se) | mg/kg | max 20 |

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Specifikimet janë hartuar në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare përkatëse konkretisht Hipokloriti i Natriumit S SH EN 901: 2013.
2. Specifikat e automjetit që do të shërbejë për furnizimin e kimikateve

Furnizimi me kimikate do të kryhet me automjet të çertifikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Automjeti për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme ose të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatit.

3. Certifikata e origjinës, skeda e sigurisë dhe raport analiza duhet të shoqërojë produktin për sasi të kërkuar sipas lëvrimit periodik.
4. Kontrolli i cilësisë dhe sasisë e ngarkesave të kimikateve

Në ditën e dorzimit të ngarkesës, do të merren nga ngarkesa me përzgjedhje të paktën 3 kampione të cilat do të futen në enë të përshtatshme, të sjelle nga furnitori dhe do të vulosen dhe firmosen nga marrësi dhe transportuesi, nga të cilat një do të dorëzohet nëpërmjet autotransportuesit firmës furnizuese dhe 1 laboratorit fiziko - kimik të UKK-se ;

Njëra nga kampionet do të ruhet për kontrollin e analizës përfundimtare në rast kundërshtish nga ana e furnitorit. Në një situatë të tillë të dy palet do të ndjekin bashkarisht kontrollin e analizave pranë laboratorit të Ujësjetës mbi kampionin e tretë të vulosur si dhe mbi atë të firmës furnizuese në qoftë se mbi të nuk është vënë dorë, e ti nënshtrohen marrëveshjes së arsyeshme.

Firma furnizuese që nga momenti kur në mënyrë të verbalizuar është lajmëruar për faktin e mospërputhjes së cilësisë së ngarkesës me specifikimet teknike në përputhje me të cilat ka fituar garën, ka 3 ditë pune kohë për të prezantuar kundërshtitë e veta, në të kundërt e humb këtë të drejtë.

Në se firma furnizuese e prezanton kundërshtinë e saj në lidhje me rezultatin ose kontrollet e kryera nga laboratorit kimik i UKK-se brenda 3 ditë pune të marrjes së njoftimit verbal për mos përputhjen e ngarkesës, ajo ka një hapësirë kohore prej 5 ditë nga dita e komunikimit verbal për mos përputhjen e ngarkesës, për të bërë analizat në laboratorin e njesise vendore të kujdesit shëndetësorë Tirane e shoqëruar me një përfaqësues (kimist) nga Ukk-sha.

5. Për kontrollin e sasisë do të përdoret një peshore automjesh e cila duhet patjetër të jetë e çertifikuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Meterologjisë dhe Kalibrimit dhe që bien dakort të dyja palët.

6. Grafiku i furnizimit, dhe oraret e dorëzimit të ngarkesave

Dërgimet e ngarkesave do të bëhen në bazë të një programi, maksimumi mujor, që Drejtori i Sh.A. Ujësjetës Kanalizimeve Kamez do t'ja parashtojë firmës kontraktuese me shkresë ose me email të paktën 5 ditë më parë duke përjashtuar rastet e veçanta e të pa parashikueshme kur periudha e mësipërme mund të ulet deri në 3 ditë dhe lajmërimi mund të bëhet edhe me telefon. Kërkesa mujore për kimikate do të bëhet në sasi të dhe datat që do të jetë e nevojshme, kjo do të thotë se ka mundësi që sasi të mujore dhe datat e furnizimit me kimikatet e kërkuara të jetë pak te ndryshme ose të ndryshme krahasuar me grafikun e bashkëlidhur i cili është paraprak dhe orientues.

Dorëzimi i ngarkesave do të bëhet në Burimin e Bovillës dhe në stacionin e pompimit Valias nga e hëna deri të premte, nga ora 8.00 deri në orën 15.00.

7. Për shpenzimet

Të gjitha shpenzimet duke përfshirë ato të peshimit, të transportit dhe shkarkimit të kimikateve në Burimin të Ujit Bovillë dhe Stacionin e Pompave Valias si dhe të analizave që do të bëhen përkatësisht për çdo ngarkesë dhe parti malli pranë Inspektoriatit Sanitar Shtetëror dhe Institutit të Shëndetit Publik do të jenë në ngarkim të firmës fituese.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

55 800 litra

Afatet e lëvrimit:

| Artikulli | Përshkrimi | Shuma | Destinacioni | Periudha e dorëzimit |
|-----------|------------------------------------|--------------|--------------|----------------------|
| 1 | Blerje klori 13%-15% (i lengshem) | 55 800 Litra | UKK. SHA | 12 MUAJ |
| | | | | |

NJESIA E PROKURIMIT